



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 15.09.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 10.09.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "PE-VLA-KU" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi-rregullimi i rrugëve fushore", Nr. i prokurimit- 632-26-4955-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-033-521, nxjerr:

V E N D I M

1. REFUZOHET SI E PABAZUAR kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "PE-VLA-KU" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi-rregullimi i rrugëve fushore", Nr. i prokurimit- 632-26-4955-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-033-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 07.09.2026 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. VËRTETOHET NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 07.09.2026.

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "PE-VLA-KU" SH.P.K., me dt.10.09.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi-rregullimi i rrugëve fushore", Nr. i prokurimit- 632-26-4955-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-033-521.

Autoriteti Kontraktues-Komuna e Gjakovës, me datë 15.09.2026, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar se:

Sa i përket sigurimit të tenderit, i njëjti është prezantuar në ofertën tuaj. Megjithatë, Komisionit Vlerësues nuk i është hapur file përkatës dhe kjo është evidentuar si gabim teknik.

Pretendimi juaj, edhe pse është i bazuar në këtë rrethanë, nuk e ndryshon vendimin e AK-së, pasi oferta juaj është me çmim më të lartë dhe, për më tepër, nuk i plotëson disa nga kërkesat e përcaktuara në FDT.

Gjithashtu, në Aneksin 7, ju keni prezantuar një listë që i referohet një projekti tjetër dhe jo projektit të kërkuar në kuadër të kësaj procedure të prokurimit.

Ndërsa, sa i përket paisjeve:

- **Nr.9-Makinë me standere CE ne mbrojtje ndaj Pluhurit;**

Kjo paisje mungon.

- **Nr.10-Cilinder me dhëmbeza dhe teh i pajisur për nivelizim min 20t;**

Fatura e shitbjeve për këtë paisje nuk përkon me dudin doganor.

- **Nr.11-Aparat PS për matjen e refilitivitetit në rrugë;**

Kjo paisje nuk i plotëson kërkesat.

- **Nr.12 -Traktor i paisur me makine speciale për punimen e bankinav dhe kran me min 8 metra gjatës;**

Kjo paisje mungon.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kopje:

Operatorit Ekonomik;

Zyrës së Kryetarit të Komunës;

Të gjitha palëve të interesuara;

FATON GUTAJ

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi